

Lush CULAJ

Instituti Albanologjik
Prishtinë

PRESIDENTI WILSON DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE 1919-1920 - DISKUTIMI NË PARLAMENT ME RASTIN E VDEKJES SË TIJ

Punim studimor

Përmbajtja e shkurtër: Në mbledhjen e 11. II. 1924 në Parlamentin e Tiranës u diskutua për Presidentin Wilson. Jehona e vdekjes së tij u pasqyrua menjëherë edhe në shtypin shqiptar. Mbi personalitetin e Wilsonit do të flitej përsëri në Kuvendin Kushtetues pas disa ditësh, më 11 shkurt. Meqenëse Fan Noli nuk kishte qenë i pranishëm në mbledhjen e 4 shkurtit e kërkoi fjalën dhe foli me shumë pasion për presidentin Wilson. Noli përmendi arsyen pse Shqipëria merrte pjesë në dhimbje përkrah SHBA-ve në ato ditë zie për këtë President.

Fjalimi i Nolit në Parlament u shoqërua me duartrokitje, që ishte një tregues i qartë se si u prit ky fjalim, por pati edhe reagime dhe një ndër ata që replikoi ishte deputeti Hilë Mosi, i cili shprehu rezerva ndaj vlerësimit aq të lartë që Noli ia bëri rolit të Wilsonit në mbrojtje të çështjes shqiptare.

Kundër kritikuesve të presidentit Wilson më ashpër ishte shprehur Faik Konica. Përgjithësisht pasqyrimi i figurës së Wilsonit, në qarqet shqiptare, është parë nga dy dimensione të kundërta. Është dhënë si figurë që i kontribuoi çështjes shqiptare dhe si figurë që nuk ndihmoi sa duhet në të mirë të saj. Kemi të bëjmë me një pasqyrim të ngjashëm me atë që është vënë në dukje nga studiuesit: se në realizimin e programit të tij në plan evropian dhe botëror Wilsoni më

shumë dështoi sesa fitoi, për shkak të opozitës evropiane në radhë të parë.

Fjalët çelës: *Presidenti Wilson, Parlamenti Shqiptar, Paqja e Versajës, SHBA, Fan Noli, Faik Konica, shtypi shqiptar*

Shqiptarët në Versajë do t'i përfaqësonin disa delegacione, por delegacioni kryesor ishte ai i Qeverisë së Durrësit, i përbërë nga: Turhan Pashë Mehmeti, kryetar, imzot Luigj Bumçi, Mehmet Konica, Luigj Gurakuqi, Mihail Turtulli dhe Mustafa Kruja.¹ Në këtë delegacion Gjergj Fishta merrte pjesë si ekspert.² Shqipëria merrte pjesë në Konferencën e Paqes në Paris në kategorinë e katërt dhe vetëm me letërkëmbim, ose në rast se e ftonte njëra nga pesë Fuqitë kishte të drejtë ta dërgonte vetëm një delegat.³ Kontaktet personale ishin anësore (marginale) dhe me njerëz pa ndonjë rëndësi të veçantë, kurse propaganda në shtyp ishte e pamundur, sepse gazetat me ndikim, për simpati, apo për para, anonin të gjitha nga fqinjët tanë që kishin aspirata territoriale. Në këto rrethana të krijuara, në kuadër të të cilave, sipas disa lajmeve “jozyrtare”, flitej për reduktimin e mëtejshëm të Shqipërisë londineze, shqiptarët të brengosur shihnin tek Amerika dhe presidenti i saj Wilson shpresën e vetme për një lloj garancie për pavarësi. Thënë realisht, përpjekjet shqiptare për ta siguruar mbështetjen amerikane për çështjen shqiptare kishin filluar qysh në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX në të përkohshmet e shqiptarëve të Amerikës, si: “Kombi”, “Dielli”, “Trumpeta e Krujës”, “Revista e Adriatikut”, si dhe disa të përkohshme të tjera që dilnin në gjuhën shqipe, atë angleze, apo në të dyja gjuhët.

¹ Peter Bartl, *Shqipëria nga mesjeta deri sot*, “Drita”, Prizren, 1999, f. 177-178; Hakif Bajrami, *Lidhja kosovare për të vërtetën e Kosovës, fejtun* “Bujku”, Prishtinë, 24. 7. 1995, f. 13; Antonello Biagini, *Storia dell Albania-dalle origini ai giorni nostri*, Milano 1999, f. 107; Mithat Frashëri, *Shqiptarë dhe sllavë*, Tiranë 1998, f. 6.

² Sejfi Vllamas, *Ballafaqime politike në Shqipëri*, Tiranë 1995 f. 109.

³ *Istoriya Diplomatiye III 1919-1939* V. P. Potemkin Beograd 1951, f. 34; Xheladin Shala, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1918-1924*, punim magjistature, Prishtinë, 1979, f. 32.

Presidenti Wilson ishte për një rend të ri botëror

Presidenti Wilson ndikoi në pjesëmarrjen e SHBA-së në luftën përkrah Fuqive të Antantës. Në mbarimin e kësaj lufte ai e kryesoi delegacionin amerikan në Konferencën e Paqes, që u mbajt në Paris në vitet 1919-1920. Me propozimet për vendosjen e një paqeje të drejtë dhe si ideatori kryesor i krijimit të Lidhjes së Kombeve, Wilsoni u bë shumë i njohur në arenën botërore.

Në situatën e tillë të krijuar në Evropë, ku kishte kundërthënie të mëdha dhe ku ndesheshin interesa të ndryshme, idetë e reja që presidenti Wilson sillte nga SHBA-ja në politikën botërore nuk buronin nga formimi i tij ideologjik, sepse ai nuk kishte aspak të bënte me socialistët evropianë, por buronin nga prirja e tij shumë përparimtare e vizionare për një botë në paqe, prosperitet dhe për një politikë të bazuar në një moral të lartë njerëzor. Doktrina e Wilsonit shprehte në thelb qëndrimin amerikan kundër konceptit evropian të ekuilibrit të forcës dhe imoralitetit të zbatimit të realpolitikës. Wilsoni dhe Amerika ishin për një rend të ri botëror të dominuar nga demokracia, nga siguri kolektiv dhe e drejta e popujve për vetëvendosje.⁴ Në fjalimin e tij, të konceptuar në katërmbëdhjetë pika, Wilsoni, duke përshkruar sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, e zëvendësoi “diplomacinë e vjetër” me diplomacinë e hapur, të bazuar në marrëveshje ndërkombëtare të detyruara për palët nënshkruese.

Idetë e Wilsonit prekën drejtpërdrejt edhe Evropën Juglindore në krizën e saj. Ndonëse, pikërisht në pikat e fjalimit të tij për këtë pjesë të Evropës e në përgjithësi për Krizën e Lindjes vërehen aspekte më inkonsistente, më ambiguitive dhe më të paditura të Wilsonit.⁵ Në mënyrën më tipike, nga Konferenca e Paqes në Paris dhe Traktati i Versajës, Ballkani u bë terreni ku u përplasën idetë wilsoniane, leniniste dhe ato liberal-kapitaliste.⁶ Në rrethanat e tilla populli shqiptar i drejtoi sytë nga SHBA-ja, duke kërkuar mbështetjen e saj, gjegjësisht të presidentit Wilson.⁷

⁴ Lisen Bashkurti, *Shqiptarët në rrjedhat e diplomacisë*, Tiranë 2003, f. 157.

⁵ *Po aty*, f. 158.

⁶ *Po aty*, f. 177.

⁷ Ekuilibri i mëparshëm i forcave në rrafshin ndërkombëtar, nga i cili mund të përfitonte çështja shqiptare, ishte prishur dhe ishte në dëm të saj. Austro-Hungaria

Wilsoni i kishte thënë Nolit: Unë do ta kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes dhe atë do ta përdor në favor të Shqipërisë

Presidenti Wilson kishte mbajtur një konferencë të kombeve të shtypura në Uashington, më 4 korrik, me rastin e ditës së shpalljes të Pavarësisë së SHBA-së. Fan Noli e përfaqësonte Shqipërinë. Atë pasdite delegatët kishin hipur në jahtin presidencial dhe përmes lumit Potomac kishin shkuar te varri i Xhorxh Uashingtonit në Vermont. Sipas zakonisht amerikan, Wilsoni kishte krijuar një atmosferë familjare për të ftuarit, duke i pritur bashkë me familjen e tij. Presidenti jo se nuk kishte dijeni për Shqipërinë. Ai kishte dëgjuar nga miku dhe këshilltari i tij Charles Crane.⁸ Aty Noli kishte biseduar me presidentin Wilson, duke i folur për pavarësinë e Shqipërisë. Wilsoni i kishte thënë: “Unë do ta kem vetëm një zë në Konferencën e Paqes dhe unë do ta përdor zërin tim në të mirë të Shqipërisë.”⁹ Në fakt, kontaktet e para të Wilsonit me shoqata shqiptare ishin vite më parë, kur shqiptarët e Amerikës e njoftonin për gjendjen e shqiptarëve në Serbi, Mal të Zi e Greqi.¹⁰

Më 15 dhjetor 1918, përmes një letre, disa studentë shqiptarë (Jani Basho, Remzi Baçi, Nush Bushati, Xhevat Korça, Raqi Buda, Fuad Asllani, Gjovalin Gjadri, Luigj Kakariqi dhe H. Hifsi) në Vjenë i paraqitën një lutje presidentit amerikan, Wudro Wilson, në të cilën, ndër të tjera, theksohet: “Sot kur fati i botës varet aq shumë prej jush, kur çdo e vetme minutë e z. Suaj do të jetë e zënë për çështjet e së ardhmes, natyrisht do t’u duket guxim i pafalshëm që një grup

që e kishte mbështetur çështjen shqiptare në Konferencën e Londrës e kishte humbur luftën. Te një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve e sidomos atyre të Amerikës shpresa e vetme ishte Presidenti Wilson.

⁸ Ndrëçim Kulla, Noli-Wilson, takim historik për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane, publikuar në internet me datën 8.4.2019.

⁹ Fan S. Noli, kompleti i veprave, vepra IV, Botimet Dudaj, 2007, Tiranë, f. 230, Robert Papa, *Pragmatizëm SHBA ndaj Shqipërisë*, Koha, Tiranë, 2000, f. 24, Hakif Bajrami, Mizoritë serbe kundër shqiptarëve në Kosovë-Rugova, Plava e Guçia në gërmadha, 1918-1921, Klubi i Intelektualëve të Rugovës, Prishtinë, 2020, f. 148. Ndrëçim Kulla, punimi i cituar, Anton Çefa, Si sot 100 vjet më parë, Fan Noli takoi Presidentin Wilson, në 4 korrik 1918, (Pjesë e shkëputur nga një ese e autorit për aktivitetin e Federatës Vatra, botuar në gazetën Iliria.

¹⁰ Hakif Bajrami, Mizoritë serbe kundër shqiptarëve,..... , vep. cit. f. 147.

studentësh të një kombi jo shumë të dëgjuar t'u luten për një të katërtën e orës tuaj shumë të çmuar. Duket se jemi krejt të harruar, sikur i përkasim historisë së vjetër.” Studentët e mbyllin letrën e tyre me fjalët: “... Zotëri, ju lutemi, në emër të djalërisë shqiptare e të kombit shqiptar, ta merrni këtë komb fatkeq nën mbrojtjen tuaj”.¹¹

Më 18 dhjetor 1918, Hasan Prishtina i drejtohet me një telegram presidentit Wilson në Paris. Në emër të shqiptarëve kërkon mbrojtjen e të drejtave të tyre në Konferencën e Paqes dhe gjetjen e mundësisë për t'i paraqitur argumentet nëpërmjet përfaqësuesit shqiptar, duke theksuar padrejtësinë me vendime të marra në Konferencën e Londrës, ku shumica e shqiptarëve mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar.¹²

Në Arkivin Qendror të Shtetit ruhen mjaft dokumente që bëjnë fjalë pikërisht për kërkesat e shqiptarëve drejtuar Qeverisë amerikane për mbështetje të interesave të saj pavarësishte. Në një letër që mban datën tetor 1918, drejtuar Qeverisë italiane, nga një grup atdhetarësh, në mes tjerash, lexojmë: “...Populli shqiptar, i bindur në të drejtën e tij për të qenë i lirë dhe i pavarur, dëshiron të jetojë në paqe në shoqërinë e kombeve. Për këtë i bën thirrje botës liberale italiane ta mbrojë çështjen e tij, konform me parimet e shpallura nga Wilsoni dhe pranuar nga aleatët”.¹³

Protektorati amerikan shihej si shpëtim për Shqipërinë

Revista e Adriatikut u bë organi më efikas i kërkesave aspiratave dhe idealeve të shqiptarëve të Amerikës. Në numrin e saj të shtatorit 1918, delegati i “Vatrës” në Londër, Mehmet Konica, boton apelin në gjuhën angleze të titulluar “Një thirrje miqve amerikanë”. Zotëri Konica, pasi elaboron shumë veti të shqiptarëve, paraqiti propozimin se Shqipërisë i nevojitet një mandat protektorati për ta konsoliduar pavarësinë e saj. Por, shkruan ai, protektorati mbi Shqipërinë nga çdo fuqi që ka interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri është “kolonizim,

¹¹ Nevila Nika, gazeta “Shekulli” Tiranë, 6 tetor 2003.

¹² Hasan Prishtina, *Dokumente*, Tiranë, 1983, f. 99-100.

¹³ Nevila Nika, Alb Philly. Com - *Një rikthim i vullnetit të pa plotësuar të presidentit Wilson*, gazeta “Shekulli” 6 tetor 2003.

cenim i të drejtave kombëtare dhe shfrytëzim ekonomik”.¹⁴ Sipas mendimit të tij, vetëm protektorati amerikan mund ta ndihmojë Shqipërinë. “Sido që të jetë, përfundon ai apelin, është dëshirë unanime e shqiptarëve, që t’i drejtohen Amerikës për ndihmë dhe ta lusin atë për të vënë mandatin mbi Shqipërinë për një periudhë pesëvjeçare, në mënyrë që vendi të ketë kohë për t’i aktivizuar të gjitha fuqitë e tij organizative”.¹⁵ Pastaj, më 4 janar 1919, federata panshqiptare “Vatra”, në një mbledhje të saj, miratoi një rezolutë me të cilën i bëri apel SHBA-së që të angazhohet për ruajtjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe të dislokohen ushtarët amerikanë në ato troje ku popullsia shqiptare është shumicë, në mënyrë që me kalimin e kohës, të organizohet një referendum i lirë, me qëllim që banorët të vendosin se me cilin shtet duan të jetojnë.¹⁶ Edhe kryetari i delegacionit qeveritar të Durrësit në Konferencën e Paqes, në fillim të marsit 1919, kërkon mandatin amerikan për Shqipërinë, i cili duhej t’i përfshinte si Çamërinë e okupuar nga ushtria greke, ashtu edhe trojet shqiptare të Veriut dhe të Lindjes, të aneksuara nga serbët dhe malazezët dhe se gjatë mandatit amerikan popullsia e këtyre trojeve të ketë të drejtë ta organizojë plebishitin.¹⁷

Më 7 dhe 11 mars 1919 delegacioni shqiptar, në krye me Luigj Bumçin, ia dërgoi dy memorandume të tjera kryetarit të Konferencës së Paqes, meqë ndodhën ngjarje të reja gjatë atyre muajve. Në ato memorandume delegacioni shqiptar protestoi kundër dhunës ndaj shqiptarëve nën regjimin e Mbretërisë SKS. U kërkuar që në bazë të programit të 14 pikave të presidentit Wilson, të krijoheshin kushte të përshtatshme dhe në mbështetje të parimit të së drejtës për vetëvendosje të kombeve shqiptarët të përcaktoheshin lirisht për fatin dhe ardhmëninë e vet. Në fund propozohej që në këto krahina

¹⁴Abdullah Karjagdiu, *Pse Shqipëria kërkoi mandatin amerikan në Konferencën e Paqes më 1919*, “Bota sot”, 2 prill 2003, f. 13.

¹⁵Abdullah Karjagdiu, *Po aty..*

¹⁶*Po aty.*

¹⁷Muin Çami, *Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës I Botërore*, në librin, *Çështja e Kosovës një problem historik aktual*, Instituti i Historisë – Prishtinë - Instituti i Historisë Tiranë, Tiranë, 1996, f. 139.

të vendoseshin forcat të SHBA-së me qëllim që të përgatitej terreni për plebishit.¹⁸

Në mitingun e organizuar nga shqiptarët e Amerikës në shkurt të vitit 1919, e mori fjalën Xh. Boullldvin, mik i shqiptarëve, i cili e mbrojti çështjen shqiptare, duke i mbështetur kërkesat e tyre. Më 1919, V. Hauell, sekretar i fondit për ndihmë Shqipërisë dhe dashamir i shqiptarëve, botoi në revistën “Veprimtaria e krishterë” artikullin: “Një republikë amerikane në Evropë”. Duke treguar një simpati ndaj shqiptarëve, ky autor doli me këto propozime adresuar presidentit Wilson. Fillimisht propozon që presidenti Wilson, nëpërmjet marrëveshjes me aleatët e SHBA-së, ta shpallte republikën e Shqipërisë, pastaj Amerika lypsej t’i jepte Shqipërisë të njëjtat garanci dhe ndihma që ua kishte dhënë më parë Kubës dhe Filipineve. Së fundi, propozohet formimi i një qeverie vendëse shqiptare, përfaqësuesit e së cilës, sipas tij, ishte me vend të përzgjidheshin, brenda mundësive, nga shqiptarët e Amerikës.¹⁹

Kundërthëniet ndërmjet Wilsonit dhe udhëheqësve të tjerë të Konferencës ishin të mëdha

Në Paris kundërthëniet ndërmjet presidentit Wilson dhe udhëheqësve të Konferencës së Paqes ishin të mëdha, sepse këta nuk pajtoheshin me parimet dhe 14 pikat e tij.²⁰ Vetë Nikola Pashiqi, udhëheqës i delegacionit të Mbretërisë SKS, në atë Konferencë i frikësohej mundësisë se mos presidenti Wilson dhe delegacioni që e udhëhiqte ai mund të ngrinin çështjen e Maqedonisë dhe të Kosovës, të mbështetur në parimin etnik dhe të vetëvendosjes, teori të cilën Wilsoni e kishte përhapur dhe e mbështeste kudo.²¹ Në cilësinë e kryetarit të Komitetit të Kosovës, Kadri Prishtina disa herë me

¹⁸ Muim Çami, Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës,....pun. cit. f. 139.

¹⁹ Abdullah Karjagdiu, Pse Shqipëria kërkoi mandatin amerikan, pun. cit., 3 prill 2003, f. 13.

²⁰ *Historija diplomacije - Diplomacia u razdoblju pripremanja drugog svetskog rata 1919-1939*, nga grup autorësh nën redaksinë e akademik Potemkinit, Zagreb, 1951, f. 24.

²¹ Izber Hoti - *Kosova në Konferencën e Paqes 1919-1920*, “Kosovarja” Prishtinë, 9.4.1992.

shkresa iu drejtua presidentit Wilson për ta informuar për atë se çka ndodhte në territoret e pushtuara shqiptare. Në prill të vitit 1919 presidenti Wilson e autorizonte Ambasadën amerikane në Romë që ta informonte Komitetin e Kosovës se po interesohej për Shqipërinë. Ambasadori në telegramin që ia dërgonte Komitetit theksonte: “Duke e zbatuar urdhrin e presidentit Wilson, kam nderin t’ju informoj se nota e juaj ka arritur dhe se gjendja e përbrendshme e Kosovës ka për t’u përmirësuar”.²²

Më 24 prill 1919 Komiteti i Kosovës, në një letër dërguar parisë në Kosovë, e informonte atë mbi pozitën e Shqipërisë në Konferencën e Paqes, duke shfaqur shpresat në presidentin Wilson dhe në SHBA-në: “Kanë marrë në mbikëqyrje të drejtpërdrejtë çështjen tonë kombëtare, mund të besojmë se fati i atdheut ka për të pasur një përfundim të mirë”.²³ Mirëpo, ndër të gjithë amerikanët që e përkrahën çështjen shqiptare, Telford Eriksoni e paraqiti propozimin më të mirë rreth mandatit amerikan. Memorandumi i tij mban titullin “Gjashtë arsye për të cilat Amerika duhet të bëhet mandatarë e Shqipërisë” (Paris 1919). Arsyet e Eriksonit ishin jo vetëm të argumentuara, por edhe logjike dhe bindëse.²⁴

Më 6 maj 1919 Komiteti i Kosovës i drejtohet me anë të një letre falënderimi presidentit Wilson, në të cilën, ndër të tjera, theksohet: “Më 25 prill 1919 patëm nderin me e marrë letrën të datueme me 15 kallnor 1919 që naltësia e juaj e keni pasë mirësinë me na e dërguar në emër të naltësisë së tij Z. Wilsonit, president i naltë i SHBA-ve përmes të cilës lajmërohem i se janë marrë parasysh raportet që kemi paraqitë mbi gjëndjen e vajtueshme të Kosovës. Bashkë me shumë raporte në lidhje me ngjarjet tragjike që kanë ndodhur mbas datës së sipërshkrueme, ju kemi paraqitë edhe një statistikë të Kosovës. Shpresojmë se keto raporte tonat do ta kenë fatin e mirë të shqyrtohen nga sytë përkrahës të drejtësisë të naltësisë së tij z. Wilsonit dhe do të

²² Lush Cula j - *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997, f. 58; *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920*, vëllimi I, Tiranë, 1980, f. 17.

²³ *Lufta e popullit shqiptar*,.....vep. cit. f. 179.

²⁴Abdullah Kar jag di u, pun. cit., 4 prill 2003, f. 13.

ndëgjohen me veshin e drejtësisë e të keqardhjes vajtimet e kushtrimet që kemi ngritë”.²⁵

Wilsoni identifikoi, në mënyrë të saktë, disa nga sfidat kryesore të shekullit XX, në mënyrë të veçantë se si mund të vihej forca në shërbim të paqes. Por, zgjidhjet e tij shpeshherë përzierin problemet që ai identifikonte. Ai ia atribuonte konkurrencën në mes shteteve kryesisht mungesës së vetëvendosjes dhe motiveve ekonomike. Por historia flet për shumë shkaqe të tjera të konkurrencës, më të shpeshta, ndër të cilat dallohen fuqizimi dhe ekzaltimi i sunduesit ose i grupit sundues.²⁶ Meqenëse Konferenca zvarritej nga dita në ditë për një dashamirës të njerëzimit si presidenti Wilson, ishte e pamundur të jepte leje që Konferenca të vazhdonte pa kufi, duke shkaktuar anarki nëpër botë. Pra, e vetmja mënyrë që t’u gjendej ilaçi të gjitha sëmundjeve ishte që të arrihej një paqe e qëndrueshme mbi baza drejtësie sipas parimeve të presidentit Wilson.²⁷

Duke e vlerësuar në të dyja anët, në Jug e në Veri, Komiteti i Kosovës dhe shqiptarët mendonin se fati i Korçës nuk dallonte nga ai i Shkodrës, duke konsideruar se këto dy kala të shtrenjta të Shqipërisë ishin vënë në pazarllëk në Paris.²⁸ E irrituar me vendimin që Vlora të mbetej nën protektoratin italian, gazeta “Dielli” e sulmonte edhe presidentin amerikan, Wilsonin, ku theksohej: “Presidenti Wilson me 14 pikat e tij të famshme e dënonte Vlorën shqiptare kundër Fiumës²⁹ zotërisht italiane. Nuk mund të ketë gjë më të tmerrshme që njeriu të gënjëhet për diçka të sigurt. Shqiptarët kanë qenë të bindur kurdoherë në padrejtësitë diplomatike dhe në shkopinjte që janë thyer kurdoherë në kokën e tyre, e dimë se peshku i madh e ha të voglin dhe se kryefjala “forca vjen përpara të drejtës” nuk e ka humbur kurrë vlerën e kuptimit të saj.”³⁰ Po kjo gazetë, duke e cituar Mihail Gramenon, theksonte: “Kur presidenti Wilson bëri rekomandimin që Vlora t’i mbetet Italisë ishte nën përshtypjen se kabineti i Turhan Pashë Mehmetit, anëtarët e “Vatrës” që e përbëjnë shumicën e

²⁵ AQSH fondi 846, dosja 28/3 f. 59. Lush Culaj, *Komiteti vep. cit.* f. 63.

²⁶ Henry Kissinger, *Diplomacia*, LAERT, Tiranë 1999, f. 226-227.

²⁷ *Dielli*, 7 prill 1919.

²⁸ AQSH, fondi 822, dosja 21.

²⁹ Fiumja ishte qytet në pjesën bregdetare të Kroacisë apo Rijeka e sotme.

³⁰ *Dielli*, 2 maj 1919.

shqiptarëve të Amerikës dhe Fan Noli nuk kishin gjë kundër që Vlora t'i jepej Italisë.” Ky ishte shpjegimi që Gramenoja e dërgon nga Parisi, duke e akuzuar politikën e kryeministrit dhe të kryetarit të delegacionit shqiptar Turhan Pashë Mehmetit dhe të “Vatrës”, duke theksuar se ne tani në vend se të bëjmë ndonjë tjetër punë nevojitet t'i rregullojmë gabimet e politikës së tyre.³¹

Përfaqësuesit amerikanë çështjen shqiptare nuk e njihnin sa duhej

Në një ndër letrat e shumta që delegacioni qeveritar ia dërgoi presidentit Wilson, në atë të 8 majit 1919, ndër të tjera, theksohej: “Na duket e padrejtë z. kryetar që në vend që të merren parasysh kërkesat tona kombëtare, po mendohet me u falun tjera copa të tokës shqiptare për me kënaqun lakmitë e fqinjve tanë, ose për me e rregulluar një ngatërresë që s'i perket në asnjë mënyrë Shqipnisë”.³² Vlen të theksohet se, me gjithë shkresat dhe memorandumet e ndryshme, fatkeqësisht përfaqësuesit amerikanë çështjen shqiptare në përgjithësi dhe atë të Kosovës në veçanti, asokohe nuk e njihnin sa duhej. Madje, atë e njihnin me ngjyra shumë të errëta, siç e paraqiste literatura voluminoze dhe me përmbajtje kryesisht propagandistike, e shkruar nga autorë të vendeve fqinje.³³

Delegacioni qeveritar përpiqej me çdo kusht ta paraqiste në mënyrë sa më të denjë në konferencë çështjen shqiptare. Vetë kryeministri dhe kryetari i delegacionit qeveritar vendosi që delegacionit t'i printe imzot Luigj Bumçi, ndërsa sekretar të ishte Gjergj Fishta³⁴. Si diplomat i vjetër e i urtë, duke e njohur pozicionin e Shqipërisë, Turhan Pashë Mehmeti e kuptoi se për të pasur gjasa

³¹ Dielli, 2 maj 1919.

³² *Shqipnia përpara Konferencës së Paqes*, dokumenta zyrtarë të paraqitur nga dërgata shqiptare, ble i parë.

³³ M u i n Ç a m i, *Shqiptarët për problemin e Kosovës në mbarim të Luftës së Parë Botërore*, në librin *Çështja e Kosovës një problem historik aktual...*, vep. cit., f. 138-139.

³⁴ Aurel Plasari, *Vija e Todosit rishfaqet - nga t'ia mbajnë shqiptarët?* Tiranë, 1992, f. 29; Lush Culaj, *Imzot Luigj Bumçi në mbrojtje të çështjes kombëtare 1919-1920*, “Shpresa”, Prishtinë, nr. 5-6, Prishtinë, nëntor-dhjetor 1998 f. 18-19.

fitimi ishte më e udhës që para kancelarive evropiane të paraqitej një prelat katolik, se një ish-ambasador i Turqisë në Petersburg.

Megjithatë, përpjekjet e shqiptarëve për ta sensibilizuar dhe për ta informuar realisht opinionin ishin të vazhdueshme. Në gushtin e vitit 1919, Luigj Bumçi, kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes, paraqet një ankesë dhe ia dërgon një apel presidentit të SHBA-së, Wilsonit, duke kërkuar intervenimin amerikan për t'u mbrojtur nga politika e Greqisë, Serbisë dhe Italisë. "Në këtë periudhë kritike të historisë së Shqipërisë" - thuhet në apel, - "delegacioni shqiptar i drejtohet ndjenjës së drejtësisë që ekziston në senatin amerikan, duke kërkuar mbështetjen e fuqishme nga ai për t'i mbrojtur të drejtat e shqiptarëve."³⁵

Formula e Versajës, me përpjekjen e pamoralshme për të hedhur gjithë përgjegjësinë e Luftës së Parë mbi Gjermaninë dhe për t'i ndëshkuar në mënyrë të paarsyeshme të gjitha vendet e tjera të lidhura me pellgun e Evropës Qendrore deri në Evropën Juglindore, bëri në fakt minimumin e procesit të sigurimit evropian në atë masë sa vetëm pak vite do të kalonin dhe kontinenti e bashkë me të edhe e tërë bota do të përfshihej në një luftë me përmasa të papara në historinë e njerëzimit.³⁶ Me akordin e 13-14 janarit 1920 çështja shqiptare vulosej në kuptimin më negativ: territori i 1913-s ndahej midis tri shteteve fqinje dhe Shqipëria e humbiste pavarësinë. Por marrëveshja pati po atë përfundim sikurse edhe Traktati i fshehtë i Londrës, për pavlefshmërinë e të cilit u diskutua gjatë në Konferencë.

Presidenti amerikan nuk u pajtua me kompromisin e janarit të vitit 1920

Wilsoni nuk u pajtua me kompromisin e janarit të vitit 1920 të partnerëve evropianë, ku parashikohej një copëtim më i thellë i trojeve të shtetit shqiptar nga sa ishin menduar në projektet e mëparshme të hartuara në Konferencë. Kështu, pa kaluar asnjë javë nga nota e fundit e 6 marsit të vitit 1920, që presidenti Wilson ua kishte dërguar kryeministrave të Anglisë, Lloid George dhe Francës Clemenceau, ku sqaronte qëndrimin e tij kundër kompromisit,

³⁵ Abdullah Karjagdiu, pun. cit., 4 prill 2003, f. 13.

³⁶ Lisen Bashkurti, *vep. cit.* f. 175.

Ministria e Punëve të Brendshme njoftonte më 11 mars të vitit 1920 prefekturat dhe bashkitë e Shqipërisë që t'i dërgonin “nji orë e ma parë një telegram falënderje” presidentit të SHBA-së për interesimin që po tregonte “për shpëtimin e Shqipërisë”. Nëpërmjet atij telegrami presidenti informohej se shqiptarët ishin betuar që kufijtë e vitit 1913 nuk do të lëshohen pa derdhjen e gjakut dhe që të mos merren parasysh kërkesat pushtuese të Greqisë në viset e Gjirokastrës dhe të rrethinave të saj. Pas dy ditësh u kërkuar që telegramit t'i bëhej një shtesë: “Që të mos merren parasysh kërkesat e fqinjëve tanë për të gjitha tokat e Shqipërisë si Kosovë dhe Çamëri”.³⁷

Pothuajse të njëjtin formulim e gjejmë në përhëndetjen e 26 marsit të vitit 1920, që Këshilli i Lartë e lexoi para Këshillit Kombëtar (Parlamentit) në prag të hapjes së tij të nesërmen më 27 mars. Në të falënderohej presidenti Wilson për ndërhyrjen në favor të Shqipërisë dhe shprehej njëherazi shpresa se SHBA-ja do t'i përkrahte “kërkesat tona të drejta kombëtare”.³⁸ Kërkesa të tilla ndaj presidentit të SHBA-së, si dhe falënderime për kthimin mbrapsht të kompromisit të janarit të vitit 1920 ndeshen në atë kohë edhe në shtypin shqiptar.

Për qëndrimin e Wilsonit ndaj çështjes shqiptare Parlamentin e informoi kryeministri Delvina

Informimi në parlament u bë një muaj më vonë, kur Sylejman Delvinës iu desh ta paraqiste gjendjen e jashtme të vendit. Presidenti i SHBA-së - pohoi kryeministri më 21 prill të vitit 1920 - nuk e ka pranuar kompromisin e janarit, që lidhet me kufijtë e Veriut, por presidenti mbështet projektin e 9 dhjetorit të vitit 1919, që i jep Italisë Vlorën, Greqisë i lëshohet krahina e Gjirokastrës dhe shteti shqiptar i cunguar territorialisht vihet nën mandatin e Italisë. Me atë rast kryeministri deklarohet: “Pra, mbasi neve as projekti i Wilsonit nuk na i ngjall shpresat si duhet, lypset të mundohemi me gjithë fuqinë për një bashkim të plotë, prej kah mund të vijë shpëtimi i Atdheut”.³⁹

³⁷ Abdullah Karjagdiu, pun. cit. f. 13.

³⁸ M u i n Ç a m i , *Jehona e vdekjes së Vudro Uilsonit në mjedisin shqiptar*, Studime historike, Tiranë, 2004, f. 35.

³⁹ Bisedime Parlamentare, 21 prill, 1920.

Për Wilsonin përmbajtja e këtij memorandumit “ruante deri në njëfarë mase unitetin e shtetit shqiptar”, meqë në të nuk prekeshin kufijtë veriorë të Shqipërisë, çfarë ishte parashikuar në kompromisin e 14 janarit të vitit 1920. Wilsoni u kërkoi partnerëve evropianë të hiqnin dorë nga kompromisi i tyre i 14 janarit të vitit 1920 dhe të ktheheshin te memorandumit i 9 dhjetorit të vitit 1919, që ishte hartuar bashkërisht me partnerët amerikanë. Ishte koha e përgatitjes së luftës së Vlorës, si mjet i vetëm që kishte mbetur për t’iu kundërvënë projekteve të Paqes së Versajës, të cilat cenonin rëndë pavarësinë dhe tërësinë territoriale të shtetit shqiptar.⁴⁰

Në gjysmën e dytë të janarit marrëdhëniet ndërmjet presidentit Wilson dhe kryeministrave të Francës dhe Britanisë së Madhe kalojnë momente tensioni dhe krize. Ndryshimet në pikëpamjet lidhur me rregullimin e çështjes së Adriatikut bëhen edhe më evidente. Më 20 janar 1920, sekretari i Departamentit të Shtetit, Lansing, dërgonte nëpërmjet ambasadorit amerikan Wallace një memorandum kryeministrave Clemenceau - Francë dhe Lloid George - Angli, lidhur me çështjet që qëndronin ende në rendin e ditës të negociatave ndërmjet fuqive. Fillimisht në memorandum kërkoheshin disa shpjegime lidhur me procedurën e ndjekur në rrethin e ngushtë lidhur me akordin e 14 janarit. Tërhiqej vërejtja se SHBA-ja nuk ishte konsultuar sa duhet, madje kërcënohej se në rast se do të merrej ndonjë vendim pa pëlqimin e Qeverisë amerikane dhe do të ishte në kundërshtim me pikëpamjet e saj ata nuk do ta pranonin.⁴¹

Kryeministrat, ai i Francës dhe ai i Anglisë, iu përgjigjën menjëherë Lansingut me një notë që ia dërguan ambasadorit amerikan në Paris, më 22 janar 1920, duke u arsyetuar se asnjë zgjidhje e çështjes nuk do të bëhej në kundërshtim me pikëpamjet amerikane. Vetë mandati italian mbi Shqipërinë ngjallte frikë për Qeverinë e Beogradit. Kjo logjikë e shtyu Qeverinë e Mbretërisë SKS që të hidhte poshtë ofertën e 14 janarit dhe në rrethana të tilla më shumë

⁴⁰ Muim Çami, Jehona e vdekjes së Vudro Uilsonit në mjedin shqiptar....pun. cit. f. 36-40.

⁴¹ A r b e n P u t o , *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2003, f. 319.

presupozonte të kufizohej me një shtet të dobët dhe të pavarur shqiptar sesa ta kishte afër Italinë.⁴²

Krijohet përshtypja se, me gjithë sigurimet fillestare, të dy kryeministrat synonin ta vinin përballë faktit të kryer presidentin Wilson, kur i bënë thirrje të mos pengonte nga larg “arritjen e një marrëveshjeje”, ndërsa vetë merrnin përsipër “ta informonin Qeverinë amerikane për rezultatet menjëherë pasi ato të arrinin në një konkluzion.”⁴³

Por, si reagan diplomatët dhe *Stejt Departamenti* amerikan ndaj këtyre propozimeve, kërkesave, lutjeve për ndihmë, si dhe kërkesës për mandat disavjeçar? Reagimet ishin të ndryshme, që nga mirëkuptimi deri te heshtja. Sa u përket miqve amerikanë të shqiptarëve të Amerikës, në të shumtën e rasteve ata tregonin një simpati, solidaritet dhe përkrahje. Nga ana tjetër, entuziazmi dhe glorifikimi i programit të presidentit të SHBA-së, Wilson, për të drejtën e vetëvendosjes, si e drejtë e patjetërsueshme e çdo populli të shtypur, nxiti dhe i entuziazmoi më tepër shqiptarët e Amerikës për veprimtarinë e tyre në dobi të kombit.

Në pranverën e vitit 1920, Robert Hamond, zëvendëskonsulli amerikan në Romë, i cili ishte dërguar në një mision të posaçëm hulumtues në Shqipëri, në raportin dërguar Stejt Departamentit, shkruan: “Shqipëria është një vend i shkëlqyeshëm për zhvillim, sepse ka pasuri natyrore. Shqiptarët në përgjithësi e duan dhe e admirojnë SHBA-në; ata i çmojnë lart idealet amerikane. Këto i kam dëgjuar nga përfaqësuesit e të gjitha shtresave të vendit... Ata kërkojnë mandatin amerikan mbi Shqipërinë.”⁴⁴

Parlamenti i Shqipërisë e nderoi kujtimin e Wilsonit - paralelisht u kërkua nderim për Leninin

Vudro Wilson vdiq më 3 shkurt të vitit 1924. Të nesërmen, më 4 shkurt, në Kuvendin Kushtetues në Tiranë u propozua mbajtja e 5 minutave nderim në kujtim të tij.

⁴² *Po aty*, f. 318.

⁴³ *Po aty*, f. 320.

⁴⁴ Abdullah Karjagdiu, pun. cit. 5 prill 2003, f. 13.

Në mbledhjen e 4 shkurtit 1924, deputeti Rauf Fico do të theksonte, ndër të tjera: “Me hidhërim morëm lajmin për vdekjen e ish-Presidentit të SHBA-ve W. Wilsonit. Duke marrë parasysh shërbimet e mëdha që i ka bërë Shqipërisë propozoj të bëhen 5 minuta nderim në shenjë hidhërimi dhe t’i dërgohet një telegram ngushëllimi familjes të ndjerit.”⁴⁵ Nga ana tjetër deputeti Jashar Erebara kërkon të bëhen 5 minuta nderimi për udhëheqësin rus, Leninin.⁴⁶ Deputeti Avni Rrustemi shpreh keqardhje se kur përmendet emri i Leninit dëgjohen të qeshura në sallën e Parlamentit. “E dinja se propozimi i Erebarës nuk do të pranohej, por megjithatë e kemi për detyrë ta propozojmë që të bëhen 5 minuta nderim si shenjë hidhërimi për vdekjen e tij.”⁴⁷ Ndërsa në mbledhjen e 11. II. 1924 u diskutua në Parlament për Presidentin Wilson.⁴⁸

Jehona e vdekjes së tij u pasqyrua menjëherë edhe në shtypin shqiptar.⁴⁹ Mbi personalitetin e Wilsonit do të flitej përsëri në Kuvendin Kushtetues pas disa ditësh, më 11 shkurt. Meqenëse Fan Noli nuk kishte qenë i pranishëm në mbledhjen e 4 shkurtit, e kërkoi fjalën dhe foli me shumë pasion për presidentin Wilson. Noli përmendi arsyen pse Shqipëria merrte pjesë në dhimbje përkrah SHBA-së në ato ditë zie për këtë President.⁵⁰

Fan Noli: Evropa nuk e deshi paqen e Wilsonit dhe Amerika e refuzoi këtë paqe

Noli, ndër të tjera, theksoi: “Titulli *amerikan* mjafton që ta bëjë popullin tonë të marrë pjesë në çdo vajtëm të Amerikës, se të gjithë e dimë sa të mira kemi parë prej saj. Që më 1900 Amerika ka qenë kurbeti më i madh i shqiptarëve. Të gjithë e dinë se Guverna (Qeveria, L. Culaj) e Durrësit u organizua nën kryesinë dhe me iniciativën e një delegati të “Vatrës” të dërguar për këtë qëllim me para të Amerikës. Në vijim ai do t’i përmendë disa të mira që kanë ardhur prej Amerikës

⁴⁵ Bisedime Parlamentare, 1924, f. 80, Shyqeri Hysi, Rauf Fico- shtetar dhe diplomat i shquar, (Monografi), Tiranë, 2007, f. 63.

⁴⁶ Edhe udhëheqësi rus Vladimir Iliç Lenini kishte vdekur në të njëjtën kohë.

⁴⁷ Bisedime Parlamentare, 1924, f. 80.

⁴⁸ Bisedime Parlamentare, 1924, f. 85.

⁴⁹ Woodrow Wilson-i vdiq, “ Dielli”, 5 shkurt 1924, f. 1.

⁵⁰ Shyqeri Hysi, Rauf Fico..... vep. cit. f. 64.

drejtperdrejt. Pas luftës, kur Shqipëria ishte e shkatërruar dhe e pllakosur prej invazioneve të huaja, Amerika dërgoi Kryqin e Kuq që t’i lehtësojë vuajtjet. E vetmja shkollë moderne që e kemi është ajo Teknike e Amerikës. Sa i përket presidentit Wilson, përveç emrit amerikan ka edhe një emër tjetër, atë të idealistit dhe të profetit të vëllazërimit ndërkombëtar si dhe paqes të përbotshme. Presidenti Wilson ishte idealist se ishte amerikan. Ata që kujtojnë se Amerika është vendi ku njerëzia kujdesen vetëm për dollarë, nuk e njohin Amerikën. E dini cili ishte programi universal i Wilsonit në Versajë. Cili prej jush nuk ka dëgjuar për katërmëdhjetë pikat e Wilsonit të sintetizuara në paktin e Lidhjes të Kombeve? U përpoq me tërë forcën e tij që t’ua imponojë Aleatëve programin e tij, por qëllimin e tij nuk e arriti si mendoi. I vajtur në Evropë si triumfator u rikthye i zhgënjyer në Amerikë. Dhe atë copë të fitores që mundi ta shkëpusë nga thonjtë e luanëve të Versajës tani vendi i tij do t’ia rrëmbente nga duart. Senati amerikan refuzoi ta ratifikonte Paqen e Versajës dhe Wilsoni, nga zeniti më i lartë ku ka ëndërruar të hipte në historinë e botës, si njeri u rrokullis dhe u rrëzua përdhe. Dhe Evropa vazhdoi luftën nën maskën e paqes. Evropa s’e desh paqen e Wilsonit dhe Amerika e refuzoi këtë paqe. Wilsoni vdiq. Fjeti si luan profeti bujar i paqes njerëzore, ati shpirtëror i Lidhjes të Kombeve.⁵¹

Megjithatë, Wilsoni bëri më tepër se çdo njeri tjetër për independencën e Shqipërisë, duke e shpëtuar vendin tonë nga copëtimi, duke siguruar pjesëmarrjen në Lidhjen e Kombeve në kufijtë e vitit 1913. Madhështia e tij morale duket pikërisht në mbrojtjen e të drejtave të kombësive të vogla. (duartrokitje).” Më pas do të vijonte: “Në janar të vitit 1920, një erë zie dhe dëshpërimi kish rënë mbi të gjithë anët e vendit tonë, i cili qe si një i vdekur në agoni. Projekti i copëtimit të Shqipërisë, i redaktuar nga katër aleatët evropianë, ishte njohur dhe priste vetëm një firmë që të bëhej një fakt definitiv. Firma që mungonte ishte ajo e presidentit Wilson, firmë që nuk u vu në atë projekt aq të padrejtë.”⁵² Fjalimi i Nolit në Parlament u shoqërua me duartrokitje, që ishte një tregues i qartë se si u prit ky

⁵¹ Presidenti amerikan Wilson ishte ideatori dhe mbështetësi kryesor i themelimit të Lidhjes së Kombeve.

⁵² Fan. S. Noli, kompleti i veprave, vepra V, Botimet Dudaj, Tiranë, 2007, f. 201-209, Kjo pjesë e fjalimit është shkurtuar dhe ka ndërhyrje të vogla nga autori.

fjalim, por pati edhe reagime dhe një ndër ata që replikoi ishte deputeti Hilë Mosi, që shprehu rezerva ndaj vlerësimit aq të lartë që Noli ia bëri rolit të Wilsonit në mbrojtje të çështjes shqiptare. Ai, ndër të tjera, do të theksonte: “Wilsoni qe ai që pranonte që Fiumja t’i jepej Jugosllavisë tue i lanë Vlorën Italisë e viset e Jugës Greqisë.” Mendimet e ndryshme të shprehura në Parlamentin Shqiptar dhe jashtë tij për vendin që zinte Wilsoni në historinë e Shqipërisë, nga Fan Noli dhe Faik Konica në superlativ, si dhe nga tjerët, si Hilë Mosi, me rezerva u pasqyruan edhe në shtypin e kohës.

Faik Konica: Shpëtimi dhe liria e Shqipërisë i detyrohen kryesisht Wilsonit

Kundër kritikuesve të presidentit Wilson më ashpër ishte shprehur Faik Konica, i cili theksonte: “Jemi të bindur se çdo shqiptar di dhe kupton se ç’borç të madh i kemi Wilsonit. Në qoftë se ka ndonjë shqiptar që s’merr vesh se shpëtimi dhe liria e vendit (të) tij i detyrohet kryesisht Wilsonit, ai nuk është njeri dhe duhet të kemi meshirë për verbësinë dhe errësirën që i ka mbuluar trutë.”⁵³ Ai, më tutje, do të theksonte: “Shqipëria ishte dënuar me vdekje, dënimi do të zbatohet doemos, asnjë rreze shprese s’ndritte gjëkund. Por e papritura ngjau dhe kjo e papritur erdhi nga qëndrimi i Vudro Wilsonit”, vijonte më tej Faik Konica, “ndërgjegjja e drejtësisë njohu përsëri zërin e madh dhe u drodh nga gëzimi; se Wilsoni duke e mbrojtur Shqipërinë nuk e mbronte një popull të vetëm, por mbronte gjithë popujt, e mbronte parimin”. Gazeta “Dielli” e datës 25 mars 1924, duke iu kundërvënë diskutimit të Hilë Mosit në Parlament, do të theksonte ndër të tjera: “E qortoi Wilsonin se ai i dha Vlorën Italisë, ndonëse çdo njeri duhej të kuptonte, dhe shumë kuptojnë, që dhe Vlorën Wilsoni e shpëtoi tërthori: se po të mos kish ngulur këmbë Wilsoni që të bëhej një Shqipëri, s’ mund t’i jepej kurrë rasti as Vlorës që të shpëtonte nga zgjedha italiane”⁵⁴.

Shtypi shqiptar është fokusuar në rolin e Wilsonit si kryetar shteti i një fuqie të madhe me potenciale të gjithanshme në rritje, si dhe në arritjet e tij në dy periudha të vështira të marrëdhënieve

⁵³ Muin Çami, pun. cit., f. 42.

⁵⁴ Dielli, 25 mars 1924.

ndërkombëtare, në Luftën e Parë Botërore dhe në nënshkrimin e traktateve të paqes të viteve 1919-1920 me vendet që e kishin humbur luftën. Shtypi pasqyronte, në mënyrë të veçantë, platformën e tij të njohur prej 14 pikash, ku ai kishte shtruar si bazë vendosjen e paqes pas luftës, si dhe rezervat ndaj kësaj platforme të udhëheqësve të Fuqive të Mëdha evropiane, fituese të konfliktit botëror.

Në paraqitjen me zigzage të pozitës së Wilsonit në Konferencën e Paqes në Paris, shtypi shqiptar iu përmbajt zhvillimit historik të ngjarjeve duke pasuar edhe shembullin e Fan Nolit, i cili në trajtesën e tij të 11 shkurtit shfaqti, ndër të tjera, keqardhjen e thellë për atë që i kishte ndodhur presidentit të SHBA-së: “Nga zenithi më i lartë ku ka ëndërruar të hypë në histori të botës (...) u rrokullis dhe u rrëzua përdhe.”⁵⁵

Përgjithësisht pasqyrimi i figurës së Wilsonit në qarqet shqiptare është parë nga dy dimensione të kundërta. Është dhënë si figurë që i kontribuoi çështjes shqiptare dhe si figurë që nuk ndihmoi sa duhet në të mirë të saj. Kemi të bëjmë me një pasqyrim të ngjashëm me atë që është vënë në dukje nga studiuesit: se në realizimin e programit të tij në plan evropian dhe botëror Wilsoni më shumë dështoi sesa fitoi, për shkak të opozitës evropiane në radhë të parë.

Konferenca e Parisit (1919-1920) e ndryshoi hartën politike të Evropës, të Azisë dhe të Afrikës. Shqiptarët dhe përfaqësuesit e tyre ishin aktivë dhe për rrethanat e kohës arritën atë që mund ta arrinin. Rezultatet e këtyre arritjeve nuk janë për t’u nënvlerësuar. Madje, po ta kemi parasysh raportin e pabarabartë të forcave dhe rrethanat e tjera u arrit aq sa nuk shpresohet. Shqipëria vërtet mbeti si shtet i ndarë pa pjesët më vitale të saj, sepse u morën për bazë argumentet politike, por të paktën u arrit që të rifitohej pavarësia e vendit dhe sidomos të mënjanoheshin padrejtësi të reja territoriale që do të ishin tragjedi e dyfishtë për të ardhmen e kombit.

Presidenti Wilson dhe SHBA-ja për përpjekjet e tyre për ta ndihmuar çështjen shqiptare mbetën në memorien e shqiptarëve. Për këtë ka mjaft dëshmi. Profesori amerikan Elmar E. Joner, gjatë vizitës në një fshat në jug të Shqipërisë, në një gëzim mirëseardhjeje dëgjon edhe këngën e Presidentit Wilson. Ai entuziazmohet tej mase nga melodia dhe teksti i këngës, të cilën e përkthen dhe ia dërgon

⁵⁵ Muin Çami, pun. cit., f. 41.

Presidentit amerikan Wilson. Presidenti i shfaq mirënjohjen profesorit nëpërmjet një letre. Ndër të tjera, ai shkruante: “S’ka dyshim se më gëzohet zemra kur mësoj për ndjenjat e bukura që ushqejnë për mua në Shqipëri. Kujtoj se çdo takim me të tilla kombe na sqaron më së miri pikëpamjen tonë për rastet dhe përgjegjësitë tona kombëtare.”⁵⁶

Konica propozon të pagëzohet me emrin *Wilsonwille* Shën Gjergji ose Saranda

Diplomati Faik Konica, i cili shërbeu në SHBA, në vitin 1924 ia dërgoi këtë telegram kryetarit të Kuvendit në Tiranë: “Ju lutemi të shtroni si propozim në Parlament që me rastin e vdekjes së Presidentit Wilson, shpëtimtarit të Shqipërisë, duke e nderuar Wilsonin dhe Shqipërinë në sytë e botës propozoni që t’i jepet emri *Wilsonwille* ose Shën Gjergjit, ose Sarandës.” Më 12 mars 1924, nën kujdesin e Faik Konicës, arrin në shtëpinë e presidentit Wilson një kurorë e bukur me 100 trëndafila, 50 të kuqe dhe 50 të bardha të lidhura me një shirit me ngjyrat e flamurit të Shqipërisë - kuqezi, në të cilat shkruan: “From the Albanian Federation Vatra Boston Massachusetts”. Ndërsa në telegramin që ia dërgon zonjës Wilson, Konica do të shprehej: “Jepmë leje Zonjë, të bëhem me respekt dërguesi i hidhërimit të thellë që ndiejnë shqiptarët, të cilët të personi i Presidentit të madh, burrit tuaj, kanë humbur mbrojtësin e të drejtave të tyre”.⁵⁷

Mbi të gjitha vlen të veçohet fjalimi i Fan Nolit në Parlamentin Shqiptar, më 11 shkurt 1924, ku, ndër të tjera, do të theksonte: “Amerika dhe tërë bota vajtuan këto ditë vdekjen e Woodrow Wilsonit. Pranë Amerikës merr pjesë në këtë zi edhe Shqipëria, e cila e quan amerikanin e madh, idealistin bujar dhe mbrojtësin e saj më të fortë. Presidenti Wilson provoi në shekullin XX se ka një vend, i cili edhe prodhon kalorës bujarë për t’i mbrojtur jetimët, të vejat dhe të shtypurit. Qysh ta quajmë e ta vajtojmë këtë kalorës pa frikë e pa njollë, chevalier sans peur ni rep-roche! Amerika, ajo nënë bujare që

⁵⁶ Vasfi Baruti, *Presidenti Wilson dhe Amerika në memorien e shqiptarëve!*, <http://acabs.org/faqe3.htm>.

⁵⁷ Vasfi Baruti, *Presidenti Wilson... po aty*.

ia dha botës Wilsonin ka për të lindur edhe të tjerë kalorës si ai, kalorës të cilët do të vazhdojnë të përfundojnë veprën e Paqes, e vëllazërimit dhe mirëdashjes ndërkombëtare”.⁵⁸

Profecia e Nolit se “Amerika, ajo nënë bujare që ia ka dhënë botës Wilsonin, ka për të lindur edhe të tjerë kalorës si ai, u jetësua pas 75 vjetësh. Amerika e Madhe lindi kryekalorësin Bill Klinton, burrë i madh i shekullit që ishte në ballë të aksionit për t’i sjellë lirinë Kosovës.”⁵⁹

Mbështetja nga ana e SHBA-së dhe presidentit Wilson, e shumëkërkuar dhe e shumëdëshiruar nga shqiptarët, nuk ishte ajo që prisnin shqiptarët. Pikërisht në atë periudhë kohore, edhe pse Amerika ishte një fuqi ekonomike gjithnjë e në rritje, ende nuk ishte fuqi e rëndësishme politike botërore. Ndikimi dhe pesha reale e këtij vendi të madh në vendimmarrjet më të rëndësishme të botës do të ndihej me vonë, në veçanti pas Luftës së Dytë Botërore.

Për shqiptarët mbështetja amerikane ishte vendimtare gjatë viteve të fundit, sidomos gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, të Konferencës së Paqes në Versajën e vitit 1920. Ndikimi vendimtar dhe qëndrimi i SHBA-së në ballë të zgjidhjes së problemit të Kosovës, që nga viti 1999 e në vazhdim, ngjan sikur të jetë njëfarë plotësimi i premtimit të papërbushur, i cili u ishte bërë nga presidenti Wilson shqiptarëve në Konferencën e Versajës.

⁵⁸ Bisedime Parlamentare, 1924, f. 85-90.

⁵⁹ Vasfi Baruti, Presidenti Wilson.....pun. cit.

PRESIDENT WILSON AND THE ALBANIAN ISSUE 1919-1920 - THE DEBATE IN PARLIAMENT ON THE OCCASION OF HIS DEATH

Summary

At the parliamentary session held on February 11, 1924, the Parliament of Tirana discussed President Wilson. The news of his death was immediately reflected in the Albanian press. Wilson's personality would be mentioned again in the Constitutional Assembly a few days later, on February 11. Since Fan Noli had not been present at the February 4 session, he requested to speak and delivered a passionate address about President Wilson. Noli explained why Albania shared the sorrow alongside the United States during those days of mourning for the President.

Noli's speech in Parliament was met with applause, a clear sign of how well it was received. However, there were also reactions, and among those who replied was MP Hil Mosi, who expressed reservations about the high praise Noli gave to Wilson's role in defending the Albanian cause.

Faik Konica responded more harshly against the critics of President Wilson, emphasizing:

"We are convinced that every Albanian knows and understands what a great debt we owe to Wilson. If there is an Albanian who does not realize that the salvation and freedom of his country are owed primarily to Wilson, he is not a person and we must pity the blindness and darkness that have clouded his mind."

In general, the portrayal of Wilson's figure in Albanian circles has been viewed from two opposing dimensions: as a figure who contributed to the Albanian cause, and as one who did not help it sufficiently. This is similar to what scholars have noted: that in implementing his program on the European and global stage, Wilson failed more than he succeeded, due mainly to European opposition.

Nonetheless, President Wilson and the United States remained in the collective memory of the Albanian people for their efforts to support the Albanian cause. There is ample evidence of this. During a visit to a village in southern Albania, American professor Elmar E.

Joner attended a welcome celebration where he heard a song dedicated to President Wilson. He was greatly moved by the melody and lyrics, which he translated and sent to President Wilson. The President expressed his gratitude to the professor in a letter, writing among other things:

“There is no doubt that my heart is gladdened when I learn of the beautiful sentiments held for me in Albania. I believe that every encounter with such nations helps to clarify our views on national duties and responsibilities.”

On March 12, 1924, under the care of Faik Konica, a beautiful wreath of 100 roses — 50 red and 50 white — tied with a ribbon in the red and black colors of the Albanian flag, was delivered to President Wilson’s residence. The ribbon read: “From the Albanian Federation Vatra, Boston, Massachusetts.” In a telegram to Mrs. Wilson, Konica wrote:

“Permit me, Madam, to respectfully convey the deep sorrow felt by Albanians, who, in the person of your great husband, the President, have lost the defender of their rights.”

Although the support of the United States and President Wilson was highly sought and greatly desired by the Albanians, it did not meet their full expectations. At that time, even though America was a rising economic power, it had not yet become a major global political power. The real influence and weight of the United States in the world’s most important decisions would only be felt later, especially after World War II.